



INFODROIT

Fletë me karakter informativ destinuar viktimave në përputhje me dispozitat e nenit 3-7 të Kodit të Procedurës Penale

Përkufizimi i nocionit të viktimës:

Cilësinë e viktimës e fiton personi i identifikuar që ka pësuar një dëm që rrjedh nga një shkelje.

Kjo fletë shërben për të informuar viktimën:

- për llojin e mbështetjes që duhet të marrë dhe pranë kujt mund ta marrë atë, përfshirë, sipas rastit, për informacionet bazë në lidhje me qasjen në ndihmën mjekësore, në çdo ndihmë të specializuar, konkretisht një ndihmë psikologjike, dhe në një zgjidhje në fushën e strehimit;

Ju keni të drejtë të kontaktoni një shërbim të ndihmës për viktimat që ofron mbështetje psikologjik falas, siç është Shërbimi i Ndihmës për Viktimat i Prokurorisë së Përgjithshme. Ky shërbim do t'ju orientojë, sipas rastit, drejt shërbimeve të tjera të specializuara të cilat do t'ju ndihmojnë, për shembull, të gjeni strehim. Gjithashtu, mund të caktoni një takim me mjekun që ju trajton ose të konsultoheni me një psikolog ose mjek specialist.

Një listë me shërbimet kryesore ndodhet në fund të kësaj flete.

- për procedurat e paraqitjes së një padie në lidhje me një vepër penale dhe rolin e viktimës në këto procedura;

Nëse jeni viktimë e një vepre penale, keni të drejtë të paraqitni padi pranë Policisë së Dukatit të madh. Policia e regjistron padinë tuaj dhe harton një procesverbal. Për këtë qëllim, një polic ju dëgjon mbi rrethanat dhe zhvillimin e ngjarjes. Në fund të takimit, duhet ta nënshkruani padinë që do t'i transmetohet në formën e një procesverbali Prokurorisë kompetente, e cila do të shqyrtojë pranueshmërinë e padisë dhe do të vendosë për masa që do të marrë. Prokurori i shtetit do t'ju informojë brenda 18 muajve nga marrja e padisë për masat e marra.

Gjithashtu, mundë të paraqitni një padi pranë Prokurorit të shtetit kompetent nga pikëpamja territoriale ose të kërkonti të drejtat tuaja duke i drejtuar gjykatësit të hetimit një padi ku të paraqiteni si palë e dëmtuar.

- për mënyrat dhe kushtet e përfutimit të mbrojtjes;

Nëse jeni viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore ose i dhunës bashkëshortore, keni të drejtë të përfitoni, sipas disa kushteve, një mbrojtje të veçantë. Në këtë rast, ftoheni të jepni informacione më të gjera gjatë dëgjimit tuaj nga autoritetet policore ose gjyqësore.

➤ **për mënyrat dhe kushtet e qasjes në ndihmën e avokatëve dhe në asistencën ligjore në kushtet e parashikuara me ligj dhe në çdo formë tjetër këshillimi;**

Nëse nuk keni mjaftueshëm të ardhura për të përballuar kostot e shërbimit të një avokati, keni të drejtë të përfitoni asistencë ligjore në kushtet e parashikuara nga ligji i 7 gushtit 2023 për organizimin e ndihmës juridike.

Për këtë qëllim duhet të paraqisni një kërkesë lidhur pranë Dhomës kompetente të Avokatëve.

➤ **për mënyrat dhe kushtet e marrjes së një dëmshpërblimi;**

Keni të drejtë të paraqiteni si palë e dëmtuar duke i dërguar gjykatësit të hetimit një letër, në të cilën e informoni se paraqiteni si palë e dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim për dëmin që deklaroni se keni pësuar. Kjo kërkesë mund të formulohet në çdo moment të procedurës.

Jeni informuar për faktin se, në rast se vendosni të paraqiteni si palë e dëmtuar, nuk do të mund të dëgjoheni më si dëshmitar.

Në shumë situata, të drejtat tuaja për dëmshpërblim rrezikojnë të mbeten teorike, si në rastet në vijim: autori i agresionit nuk është identifikuar ose nuk gjendet ose nuk ka aftësi paguese.

Në këtë rast, nëse keni qenë viktimë e një veprë penale të qëllimshme që ju ka shkaktuar lëndime fizike dhe nëse ky dëmtim është konstatuar nga një vendim i formës së prerë, ju mund të bëni një kërkesë për dëmshpërblim pranë Ministrisë së Drejtësisë në bazë të ligjit të 12 marsit 1984 "Për dëmshpërblimin e disa viktimave që kanë pësuar lëndime fizike si rezultat i një shkeljeje dhe për luftimin e paaftësisë paguese mashtruese".

Një komision i posaçëm pranë Ministrisë së Drejtësisë do të shqyrtojë nëse janë plotësuar kushtet e ligjit dhe kryesisht kushti i lëndimit fizik të konsiderueshëm dhe do të vlerësojë dëmin tuaj.

Të dhëna plotësuese në lidhje me procedurën mund të gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë.

➤ **për mënyrat dhe kushtet e ushtrimit të së drejtës për përkthim me gojë dhe me shkrim;**

Ju keni të drejtë të informoheni dhe t'i bëni deklaratat tuaja në një gjuhë që e kuptoni. Ftoheni të informoni bashkëbiseduesin tuaj gjatë dëgjimit para policisë për gjuhën ose gjuhët që kuptoni.

➤ **për mënyrat për ushtrimin e të drejtave të saj, kur banon në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian;**

Nëse banoni në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian dhe nëse keni qenë objekt i një veprë penale në Luksemburg, ju mund të paraqisni padi pranë autoriteteve policore të Luksemburgut.

- për procedurat e disponueshme për të bërë një ankesë në rast se të drejtat e saj nuk do të respektoheshin;

Në rast se të drejtat tuaja nuk respektohen nga autoriteti kompetent që vepron në kuadrin e një procedure penale, ka rekurse të mundshme sipas formave dhe mënyrave të parashikuara në nenet 3-4 (6), 3-5 (8) dhe 23-5 të Kodit të Procedurës Penale.

- për të dhëna të dobishme për dërgimin e komunikimeve në lidhje me dosjen e tij;

Ju tërhiqet vëmendja për faktin që çdo letër në lidhje me padinë e një viktime dërgohet në adresën zyrtare që është deklaruar gjatë paraqitjes së padisë.

- për mundësitë e ndërmjetësimit dhe të drejtësisë restauruese;

Me rastin e çdo procedure penale dhe në të gjitha fazat e procedurës, përfshi gjatë ekzekutimit të dënimit, Shërbimi i Drejtësisë Restauruese (SEJURE) ofron mundësinë e fillimit të një procesi dialogu ndërmjet personave të interesuar, jashtë kanaleve tradicionale ligjore. Ky shërbim, falas dhe konfidencial, është i arritshëm për të gjithë

Drejtësia restauruese është një proces që mundëson shkëmbimin/komunikimin midis palëve të përfshira, pavarësisht nga subjekti ose forma, pra midis viktimës dhe autorit të veprës penale, me qëllim që të zbuten apo zgjidhen pasojat që ka shkaktuar vepra. Ky komunikim mund të ndodhë në forma të ndryshme, jo domosdoshmërisht ballë për ballë – mund të zhvillohet përmes profesionistëve ndërmjetësues, me letra, përmes telefonit, videokonferencës etj. Ky proces i drejtësisë restauruese zbatohet vetëm nëse të dyja palët – si viktimja, ashtu edhe autori i veprës penale janë informuar plotësisht për mënyrën se si funksionon dhe kanë dhënë pëlqimin e tyre të qartë për të marrë pjesë në të. Pjesëmarrja është plotësisht vullnetare dhe secili ka të drejtë të tërhiqet kurdoherë që dëshiron. Por është e rëndësishme të theksohet se masa e drejtësisë restauruese nuk ndalon procedurat penale.

Ndërmjetësimi penal, nga ana tjetër, është një alternativë ndaj ndjekjes penale që mund të propozohet nga Prokuroria kompetente dhe që kërkon miratimin e të dy palëve, si autorit të veprës penale, ashtu edhe viktimës.

- për mënyrat dhe kushtet në të cilat mund të rimbursohen shpenzimet e kryera për shkak të pjesëmarrjes së saj në procedurën penale;

Si viktimë, ju mund të pretendoni për të drejtat tuaja financiare në disa nivele duke u paraqitur si palë e dëmtuar, duke kërkuar një dëmshpërblim procedural në Gjykatën që vendos në themel gjatë procesit, ose me marrjen përsipër të shpenzimeve tuaja eventuale të transportit dhe të strehimit në formën e taksës për dëshmitarët.

Për këto kërkesa të ndryshme duhet të përmbushen kushtet ligjore.

- për të drejtën e saj për një vlerësim individual pranë Shërbimit të ndihmës për viktimat për të verifikuar nevojën e një trajtimi specifik për të parandaluar viktimizimin dytësor;
- në rast nevojë, do të jepen, kur është rasti, informacione shtesë, në çdo fazë të procedurës;

- përveçse kur është kundër interesave të viktimës ose mbarëvajtjes së procedurës, gjatë kontaktit të parë me oficerët dhe agentët e policisë gjyqësore, viktimë është e autorizuar për t'u shoqëruar nga një person i zgjedhur nga ajo vetë, kur, për shkak të pasojave të veprës, ajo ka nevojë për ndihmë për të kuptuar ose për t'u kuptuar;
- nëse viktimë është e mitur, ajo ka të drejtë gjatë dëgjimeve, të shoqërohet nga përfaqësuesi i saj ligjor ose nga një person që e zgjedh vetë.

SHTOJCA: ADRESA DHE INFORMACIONE TË TJERA TË DOBISHME

Shërbimet qeveritare

Shërbimi i pritjes dhe i informacionit juridik

Shërbimi i pritjes dhe i informacionit juridik Luksemburg Selia gjyqësore Bâtiment BC L-2080 Luksemburg Orari i hapjes: E hënë dhe e martë: 08:30–12:00 / 13:00–16:30 (pa takim) E enjte: 10:00–12:00 / 13:00–16:30 (vetëm me takim) E mërkurë dhe e premte: 8:30-12:00/13:00-16:30 me telefon ose postë elektronike	Shërbimi i pritjes dhe i informacionit juridik Diekirch Bei der Aaler Kirch L-9211 Diekirch Orari i hapjes: E mërkurë mëngjes: 08:30–12:00 (pa takim) E mërkurë pasdite 13:00–16:30 (vetëm me takim)
<u>Për të dy vendet në Luksemburg Diekirch</u> Telefon 475981 - 2600 Email: pgsin@justice.etat.lu Faqja e internetit: https://justice.public.lu/fr/aides-information/accueil-info-juridique.html	

Shërbimet e ndihmës për viktimat

Shërbimi i Ndhmës për Viktimat Shërbimi Qendror i Asistencës Sociale pranë Prokurorisë së Përgjithshme 12-18 rue Joseph Junck (bâtiment Plaza Liberty- Hyrja C) L-1839 Luksemburg Telefoni: 621 326 595 Më shumë informacion në: https://justice.public.lu/fr/aides-informations/accueil-info-juridique.html	Orari i hapjes: E hënë – e premte: 08:30–11:30 / 14:00–17:00 Konsultimet bëhen <u>vetëm me takim paraprak</u> Email: scas-sav@justice.etat.lu
--	---

Shërbime dhe shoqata joqeveritare për ndihmën e viktimave

Dhuna (të gjitha format)

Linja e ndihmës për dhunë (Helpline violence) Email: info@helpline-violence.lu Faqe interneti: www.helpline-violence.lu	Telefon: <u>2060 – 1060</u> E hapur çdo ditë (7/7), nga ora 12:00 deri në 20:00
Në rast urgjence telefono 113	

Qendra Kombëtare për Viktimat e Dhunës (CNVV) → Ofron mbështetje, mirëpritje me kujdes si dhe ndihmë emergjente ambulatorë. ◆ <u>E destinuar për viktimat e të gjitha moshave (të mitur dhe të rritur), që kanë përjetuar çdo formë dhune: fizike, seksuale, psikologjike, etj.</u> ◆ Shërbimet përfshijnë mbështetje psikosociale, ndihmë mjekësore, informim juridik kur është e aplikueshme ndërhyrje policore për paraqitjen e kallëzimit penal	Orari i hapjes E hënë – e enjte: ora 17:00 – 00:00 E premte: 18:00 – 02:00 (e mengjesit) E shtunë: 10:00 – 02:00 (e mengjesit) E diel: 10:00 – 00:00 Orari mund të ndryshojë në prag të festave dhe gjatë ditëve të festave. Ekipi i CBVV-së mund të kontaktohet me telefon gjatë orarit të punës ose me e-mail. Kontakti: 2755 5315 Email: info.cnvv@croix-rouge.lu Faqja e internetit: https://violence.lu/centre-national-pour-victimes-de-violences/
---	--

Për më tepër informacion rreth shoqatave ekzistuese që ofrojnë ndihmë, si dhe të dhënat e tyre të kontaktit, mund të vizitoni faqen: www.violence.lu.

Dhuna në familje (në marrëdhënie familjare, bashkëshortore apo të afërta) dhe dhuna e bazuar në gjini (duke përfshirë dhunën seksuale)	
Visavi – Jeto pa dhunë Qendër konsulence për gra – Shoqata Femmes en détresse 2, rue du Fort Wallis, L-2714 Luxembourg Telefon <u>49 08 77-1</u> Për më shumë informacion: www.fed.lu	Konsultime telefonike E hënë – E premte, 09:00–17:00 Konsultime individuale vetëm me takim në qytetin e Luksemburgut Posta elektronike: www.visavi@fed.lu
InfoMann Qendër konsulence për burra – Shoqata ActTogether - Luksemburg	Konsultime vetëm me takim të paraprak

39, rue de Bouillon, L-1248 Luksemburg Telefon <u>27 49 65</u> Për më shumë informacion: www.acttogether.lu	Orari i hapjes E hënë – E premte, 09:00–17:00 Posta elektronike: info@infomann.lu
--	--

Dhuna seksuale	
Planning Familial Selia Qyteti i Luksemburgut Q Qendra DR M.-P. Molitor-Pfeffer 6-10, rue de la Fonderie, L-1531 Luksemburg Telefon <u>48 59 76</u> Planning Familial Vendndodhja Esch/Alzette 2-4, rue Ernie Reitz / në kryqëzim me 14-16 avenue de la Gare (kati i 4-të) L-4251 Esch/Alzette Telefon <u>54 51 51</u> Planning Familial – Ettelbrück 18, avenue J.F. Kennedy L-9053 Ettelbrück Telefon <u>81 87 87</u>	Orari i hapjes: E hënë – E premte: 09:00 – 17:00 E enjte deri në 18:00 Dhe me takim të paraprak Posta elektronike: info@pfl.lu Orari i hapjes E hënë: 08:00 – 12:30 / 13:30 – 17:00 E martë, e mërkurë, e enjte: 08:00 – 12:30 / 13:30 – 16:00 E premte: 08:00 – 12:30 / 13:30 – 17:00 Gjithashtu me takim të paraprak E-mail: esch@pfl.lu Orari i hapjes E hënë deri të enjten: 09:00 – 12:30 / 13:00 – 17:00 Të mërkurën duke filluar nga ora 10:30 Gjithashtu me takim të paraprak
Për më shumë informacion, pavarësisht vendndodhjes: www.pfl.lu	

Dhuna ndaj komunitetit LGBTIQ	
Cigale asbl – Qendra LGBTIQ+ – Luksemburg Adresa: 16, rue Notre Dame L-2240 Luxembourg Telefoni: <u>26 19 00 18</u> Për më shumë informacion: www.cigale.lu	Konsultime me takim të paraprak Pa takim E martë – E premte: 12:00 – 17:00 E-mail: info@cigale.lu

Dhuna ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve	
ALUPSE Asbl – Luksemburg Adresa: 201, route de Thionville, L-5885 Howald	Konsultime vetëm me takim paraprak Orari: E hënë – E premte: 09:00 – 17:00 Konsultimet zhvillohen një herë në javë edhe në Ettelbrück

Telefon: <u>26 18 48 -1</u> dhe në raste urgjente: <u>621 232 268</u> ose <u>621 232 267</u> Për më shumë informacion: www.alupse.lu	Adresa: 4, Grand-Rue, L-9050 Ettelbrück E-mail: info@alupse.lu / alupse.bebe@alupse.lu
--	--

Alternatives – Qendër konsultimi për fëmijë dhe adoleshentë viktimë të dhunës Fondacioni Pro Familia – Esch/Alzette Adresa: 138, rue de Belvaux, L-4026 Esch/Alzette Telefon: 51 72 72 – 500 Për më shumë informacion: www.profamilia.lu	Konsultime me takim të paraprak Orari: E hënë – E premte: 08:00 – 18:00/19:00 E-mail: alternatives@profamilia.lu
S-PSYea- Shërbim psikologjik për fëmijë dhe adoleshentë viktimë të dhunës në familje Femmes en détresse a.s.b.l. Adresa; B.P. 1024, L-1010 Luxembourg Telefoni: 26 48 20 50 Për më shumë informacion: www.fed.lu	Orari i hapjes E hënë dhe e mërkurë: 08:00 – 18:00 E martë dhe e enjte: 08:30 – 18:00 E premte: 08:00 – 17:00 E-mail: psysea@fed.lu

Trafikimi i qenieve njerëzore

INFOTRAITE – Shërbimi i ndihmës për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore Fondacioni “La Porte Ouverte” Adresa: 16, avenue Marie-Thérèse, L-2132 Luxembourg Telefoni: 25 36 56 46 621 316 919 621 351 884 Për më shumë informacion: www.stoptraite.lu E-mail: info@traite.lu

Shërbimi i Drejtësisë Restauruese (SEJURE) Qendra e Ndërmjetësimit ASBL Adresa: 87, Route de Thionville L-2611 Luksemburg Telefoni: 27 48 34 64 E-mail: sejure@mediation.lu Faqja e internetit: www.sejure.lu
--